

## Ndikimi dhe implikimet e pandemisë COVID-19 në adresimin gjinor në Kosovë

**HYRJE:** Edhe pse pandemia globale COVID-19<sup>1</sup> nuk është urgjencia e parë në botë e shëndetit publik, ose e para për të cilën janë thirrur agjencitë e zhvillimit dhe ato humanitare për t'iu përgjigjur, ekziston një mungesë e studimit mbi implikimet e emergjencave të shëndetit publik në grupe të ndryshme, veçanërisht ato për gra dhe vajza<sup>2</sup>. Analiza e fundit për situatën aktuale tregon se pandemia COVID-19 në kontekst zhvillimor dhe humanitar mund të prek në mënyrë disproporcionale në disa aspekte gratë dhe vajzat, duke përfshirë efektet e dëmshme në arsimimin e tyre, sigurinë ushqimore dhe ushqyerjen, shëndetin, jetesën dhe mbrojtjen<sup>3</sup>.

Kjo tregon se adresimi i pabarazisë gjinore dhe njohja e shkallës në të cilën shpërthimi i pandemisë prek ndryshe gratë nga burrat, është thelbësore për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive krizave shëndetësore, por për më tepër është një hap themelor për të kuptuar efektet parësore dhe dytësore të një emergjence shëndetësore në individë dhe komunitete të ndryshme me qëllim për krijimin e politikave dhe ndërhyrjeve efektive dhe të barabarta.

Për këto arsye, Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës ndan shqetësimin për implikimet që përhapja e COVID-19 mund të ketë tek gratë dhe vajzat në Kosovë në kontekstin e mjedisit zhvillimor dhe atij humanitar të tyre.


Në situatën aktuale në Kosovë - me ekonomi pothuajse të stagnuar, me pezullim për zhvillim të procesit mësimor në kushte normale, dhe kufizimin e lirisë së lëvizjes, gratë përballen më shumë se zakonisht me

Adresimi i pabarazisë gjinore dhe njohja e shkallës në të cilën shpërthimi i pandemisë COVID-19 prek ndryshe gratë nga burrat, është thelbësore për të kuptuar efektet e një emergjence shëndetësore si kjo, me qëllim të krijimit të politikave dhe intervenimeve adekuate dhe efektive.

1 Organizata Botërore e Shëndetësisë. ©2020 WHO. Coronavirus Disease (COVID-19) Pandemic. Marrë nga: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019>

2 Care International. 2020. Gender implication of COVID-19 outbreaks in development and humanitarian settings. Marrë nga: [https://www.care.org/sites/default/files/gendered\\_implications\\_of\\_covid-19\\_full\\_paper.pdf](https://www.care.org/sites/default/files/gendered_implications_of_covid-19_full_paper.pdf)

3 Venham C., Smith J., Morgan R. Vol 395 Mars 14, 2020. COVID-19: the gendered impacts of the outbreak. Marrë nga: <https://www.thelancet.com/acton/showPdf?pii=S0140-i73i%22220%2293052i->



detyrimet familjare dhe punët e shtëpisë, e aq më tepër tani para tyre shtrohet një nevojë më e madhe për kujdesin e anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe të moshuarve<sup>4</sup>.

Sa i përket pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), tregu i punës karakterizohet nga një shkallë e ulët e punësimit të grave, dhe në të njëjtën kohë me një përqindje të lartë të pasivitetit të tyre në tregun e punës. Shkalla e papunësisë tek gratë është 34.3%, krahasuar me burrat 22.6%<sup>5</sup>,

ndërsa ndër arsyet kryesore që i mbajnë gratë jashtë tregut të punës konsiderohen të jenë: përgjegjësitë e përkujdesjes ndaj fëmijëve dhe të moshuarve në familje, mungesa e mundësive për punësim, diskriminimi gjinor në procesin e punësimit, pagat e ulëta si dhe kultura e theksuar patriarkale në shoqëri në lidhje me rolet dhe pritshmëritë gjinore<sup>6</sup>. Këtu është e rëndësishme të theksohet që sektorët në të cilët gratë në Kosovë janë të punësuara në një shkallë më të lartë kryesisht janë sektori i arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor me 53.0% të tyre<sup>7</sup>.

## Implikimet e mundshme gjinore të pandemisë COVID-19

1

**Normat shëndetësore e sociale:** Femrat janë kujdestaret kryesore të familjes të cilat kryejnë punët e shtëpisë dhe përkujdesen për anëtarët e sëmurë të familjes; ato konsiderohen përgjegjëse për trajtimin e sëmundjeve në nivel shtëpiak dhe përpjekjet e tyre në këtë drejtim mund t'i ekspozojnë ato ndaj rreziqeve më të mëdha shëndetësore. Si rezultat, poashtu mungesa e barazisë gjinore në ndarjen e përgjegjësive familjare mund të shkaktojë mbingarkesë të punëve shtëpiake tek gratë, e cila mund të përcillet me pasoja emocionale dhe fizike te ato.

2

**Dhuna në familje dhe krizat e mbrojtjes:** Përderisa të dhënat në Kosovën janë ende të mangëta, numri i vogël i raporteve ditore të lëshuara nga Policia e Kosovës sinjalizon një shqetësim serioz për situatën abuzive të grave në mjediset familjare. Në përgjithësi, dhuna në familje është treguar që rritet gjatë

4 Democracy for Development. Mars, 2020. Implikimet e mundshme gjinore të COVID-19 në Kosovë Marrë nga: [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2020/03/D4D\\_Analize-e-politikave\\_8.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2020/03/D4D_Analize-e-politikave_8.pdf)

5 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019). Anketa e Fuqisë Punëtore TM4 2019. Marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/5369/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2019.pdf>

6 Morina L., Delibashzade R. 2017. Joaktiviteti i grave në tregun e punës. Marrë nga: [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D\\_PI\\_12\\_W4D\\_SHQ\\_WEB.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D_PI_12_W4D_SHQ_WEB.pdf)

7 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019). Anketa e Fuqisë Punëtore TM4 2019. Marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/5369/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2019.pdf>

krizave shëndetësore, pasi që vetë-izolimi dhe karantina merren masa mbrojtëse zbatuese si strategji për të parandaluar përhapjen e pandemive.

3

**(Pa) punësimi:** Me 78.9% të joaktivitetit të grave në tregun e punës<sup>8</sup>, kriza ekonomike do të ndikojë negativisht në rritjen e punësimit të grave apo edhe kthimin e tyre në tregun e punës. Gjithashtu ato kanë më shumë të ngjarë të përfshihen në punë me kontrata afatshkurtra, në ato me kohë të pjesshme dhe punë të tjera me nivel më të ulët për sigurim të mjeteve të jetesës.

4

**Implikimet gjinore në zonat rurale:** Krizat pandemike mund të shkaktojnë kriza ekonomike dhe pasi shumica e grave rurale punojnë në ekonominë informale - d.m.th në punë me pagë të ulët dhe të pasigurt ato mund të përballen me rënie dramatike në të ardhurat e tyre e rrjedhimisht në pamundësinë e sigurimit të mjeteve të jetesës<sup>9</sup>. Gratë rurale poashtu kanë mungesë të qasjes në informacion, andaj mund të preken më shumë. Ndërsa ndikimi ekonomik i emergjencave të shëndetit publik mund të detyrojë familjet rurale të ndalojnë fëmijët e tyre, veçanërisht vajzat, nga shkolla apo edhe puna, duke çuar potencialisht në martesë të hershme të detyruara.

Këto janë vetëm disa nga çështjet me të cilat femrat në Kosovë ka të ngjarë të preken si rezultat i pandemisë COVID-19, por një analizë më e hollësishme e adresimit të dimensionit gjinor do të ofronte të dhëna dhe informacione të reja lidhur me ndikimet dhe implikimet e tjera të mundshme.

## Rekomandime

### Për të gjithë akterët

Planet strategjike për përgjigje ndaj situatës së pandemisë COVID-19 duhet të bazohen në një analizë dhe hulumtim të detajuar të adresimit të pabarazisë gjinore, sepse kështu mbyllja e boshllëqeve të mungesës së të dhënave me të gjetura të reja mundëson marrjen e veprimeve adekuate në trajtim të çështjes, tutje krijim të politikave efektive, relevante me situatën.

Ky material financohet plotësisht ose pjesërisht nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) dhe We Effect.

Përmbajtjet e kësaj analize nuk reflektojnë medoemos qëndrimet e Sida dhe We Effect.

<sup>8</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019). Anketa e Fuqisë Punëtore TM4 2019. Marrë nga:

<https://ask.rks-gov.net/media/5365/afp-tm4-2019.pdf>

<sup>9</sup> Interim Guidance: Gender alert for Covid- 19 outbreak, Mars 2020. ©2020 reliefweb.

<https://reliefweb.int/report/world/interim-guidance-gender-alert-covid-19-outbreak-march-2020>